



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:205007

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05617595

KPPP.nr.633/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbaremore të kreditorit “ProCredit Bank Kosovë” SH.A. dega në Prishtinë, me adresë në Bulevardin “Bill Clinton” pn., kundër debitorëve 1. “Shotani” SH.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 70458364, me seli në Prishtinë, adresa Magjistranja Prishtinë – Fushë Kosovë, pn., 2. B.S. nga Prishtina, rruga “...” me numër personal ... dhe 3. H.S. nga Prishtina, rruga “...” me numër personal ... të cilët sipas autorizimit i përfaqëson F.A. dhe D.O., të dy avokatë nga Prishtina, duke vendosur sipas prapësimit të debitorëve të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 452/21 të datës 30.06.2021 të lejuar nga Përmbareuesi Privat Irfan I. Kërçagu me seli të zyrës në Prishtinë, me datë 25.04.2024, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorëve “Shotani” SH.P.K., B.S. dhe H.S., SHFUQIZOHET Urdhri Përmbaremore P.nr. 452/21 të datës 30.06.2021 i lejuar nga Përmbareuesi Privat Irfan I. Kërçagu me seli të zyrës në Prishtinë, mbi bazën e dokumentit përmbaremore, Kontratës së Pengut Nr.10097723 të datës 08.06.2016.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbaremore P.nr. 452/21 i datës 30.06.2021 i lejuar nga Përmbareuesi Privat Irfan I. Kërçagu me seli të zyrës në Prishtinë, mbi bazën e dokumentit përmbaremore, Marrëveshjes për Themelimin e Hipotekës LRP.nr.1557/2014 dhe Nr.Ref. 489/2014 dhe Aktvendimit mbi Regjistrimin e Hipotekës Nr.prot.H127/2014.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “ProCredit Bank” SH.A. dega në Prishtinë ka lëshuar Urdhrit Përmbaremore P.nr. 452/21 të datës 30.06.2021, me të cilin e ka

lejuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarues Kontratës së Pengut Nr.10097723 dhe Konfirmimi i Regjistrimit të Pengut, si dhe Marrëveshja mbi Themelimin e Hipotekës dhe Aktvendimi mbi Regjistrimin e Hipotekës, duke detyruar debitorët që t'ia paguaj kreditorit shumën prej 48,961.99€ (dyzet e tetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një euro e nëntëdhjetë e nëntë cent), përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorëve, shitjes së paluajtshmërive të hipotekëlënësit apo sekuestrimit të kolateralit.

Debitorët brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin me arsyetimin se sendet në të cilat është caktuar përbarimi janë të përjashtuara nga përbarimi si dhe urdhri për lejimin e përbarimit nuk është nxjerr sipas formës së paraparë me LPP-në. Tutje ka theksuar se nuk është e lejuar vendosja e kamatës mbi kamatë. Gjykatës i ka propozuar që të merr aktvendim me të cilin shfuqizohet urdhri përbarimorë dhe procedura në këtë çështje përbarimore të përfundoj.

Përgjigje në prapësim brenda afatit ligjor ka paraqitur kreditori, i cili ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorëve duke shtuar se dokumentet në bazë të së cilave është iniciuar procedura përbarimore janë dokumente përbaruese me titull ekzekutiv. Ka kundërshtuar edhe pretendimet tjera të debitorëve sa i përket interesit. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorëve.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, rekomandimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së dytë dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi pjesërisht dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22, par. 1.7 përcaktohet se *“1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit”* kurse me nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore përcaktohet se dokument përbarues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*.

Gjykata duke vlerësuar Kontratën e Pengut Nr.10097723 e datës 08.06.2016, Listës së Pengut, librezave të regjistrimit të automjeteve të lëna peng dhe Konfirmimi i Regjistrimit të Pengut për automjetin “Hyundai 20” dhe gjeti se e njëjta nuk është paraqitur në formën e kërkuar ligjore, respektivisht nuk i është bashkangjitur shkresave të lëndës në formë origjinale apo kopje të noterizuara, siç përcakton neni 38 par. 1 të LPP-së, se: *1. Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarrimi, kërkuesi i përmbarrimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarrimi, objekti i përmbarrimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit.”.*

Në këtë drejtim, në mbështetje të nenit 71, par.1, nën-par 1.1 të LPP-së i cili përcakton se: *“Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.1. dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarrues ose urdhri përmbarrues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë”* gjykata erdhi në përfundim se urdhri për lejimin e përmbarrimit duhet të anulohet, pasi që dokumentet mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarrimi nuk kanë titull ekzekutiv.

Andaj gjykata aprovoi si të bazuar prapësimin e debitorëve dhe shfuqizoi Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 452/21 të datës 30.06.2021 të lejuar nga Përmbarruesi Privat Irfan I. Kërçagu përkitazi me dokumentin përmbarrimorë Kontratë e Pengut Nr.10097723 të datës 08.06.2016, pasi që e njëjta nuk përbën titull ekzekutiv.

Gjykata vlerësoi edhe Marrëveshjen për Themelimin e Hipotekës LRP.nr.1557/2014 dhe Nr.Ref. 489/2014 gjeti se e njëjta është paraqitur në kopje të noterizuar, e cila është vërtetuar pranë zyrës noteriale të noterit Ekrem Nuhiu me datë 28.06.2021, si dhe në shkresa të lëndës është bashkangjitur Aktvendimin mbi Regjistrimin e Hipotekës Nr.prot.H127/2014, për parcelën P-1586-2.

Andaj gjykata la në fuqi Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 452/21 i datës 30.06.2021 të lejuar nga Përmbarruesi Privat Irfan I. Kërçagu, mbi bazën e dokumentit përmbarrimorë, Marrëveshjes për Themelimin e Hipotekës LRP.nr.1557/2014 dhe Nr.Ref. 489/2014 dhe Aktvendimit mbi Regjistrimin e Hipotekës Nr.prot.H127/2014,

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të palëve mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike përmbartimore, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimit.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.633/22, datë 25.04.2024.

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.